



Datë: 28.10.2025
Numër Protokolli: 7080/2025

A.nr.1555/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.1555/2025, të datës 07.08.2025, të parashtruar nga ankuesi G.H, kundër organit të punësimit: Inspektorati Qendrorë i Punës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin dhe 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1555/2025, të datës 07.08.2025, të parashtruar nga ankuesi G.H.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, G.H (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi*), më datë 07.08.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5281/2025, të regjistruar nën shenjën A.nr.1555/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017332, për gjashtë (6) pozitat e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë-Divizioni për Inspektim në Rajonin e Ferizajit, të shpallur me datë 21.03.2025, nga Inspektorati Qendrorë i Punës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 22.08.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati Qendrorë i Punës, ndërsa kjo e fundit më datë 10.09.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1555/2025, sepse:

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i provave të lëndës, ka gjetur se Inspektorati Qendrorë i Punës, me datë 21.03.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00017332, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm-Arsimi i Lartë, gjegjësisht për gjashtë (6) pozitat e punës *Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë-Divizioni për Inspektim në Rajonin e Ferizajt*, me afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri më datë 20.04.2025.

Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 137 kandidatë, ku prej tyre 104 kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, duke përfshirë këtu edhe ankuesin, i cili ka marrë pjesë në të gjitha fazat e rekrutimit, duke arritur gjithsejtë 73.6 pikë të përgjithshme.

Tutje, sipas Njoftimit për rezultatet përfundimtare të datës 11.07.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendrorë të Punës, rezulton se procedurave përkatëse e rekrutimit ka përfunduar me gjithsejtë 19 kandidatë të cilët kanë kaluar pragun e kalueshmërisë prej 70 pikëve, ndërsa sipas pikëve të arritura nga të gjitha fazat e rekrutimit rrjedhë se kandidatë fitues për gjashtë (6) pozitat Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë, në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Ferizajit, janë shpallur: kandidatja B.S-A me gjithsejtë 91 pikë, kandidati P.J me gjithsejtë 90.8 pikë, kandidati A.R me gjithsejtë 89.4 pikë, kandidati Xh.L me gjithsejtë 85.4 pikë, kandidatja Xh.M me gjithsejtë 80.2 pikë si dhe kandidatja Xh.T-Z me gjithsejtë 80.2 pikë.

Ankuesi, në ankesën e ka parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk janë respektuar afatet ligjore, kërkon të konstatohet se nga kush është shpallur konkursi dhe po ashtu themeluar Komisioni i Pranimit, të shqyrtohet vlerësimi i jetëshkrimit dhe aplikacioni me dokumentet e tij, si rrjedhojë kërkon anulimin e konkursit përkatës.

Duke u bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati K.S, si kandidat pjesëmarrës në procedurën e rekrutimit RN00017332, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm-Arsimi i Lartë, gjegjësisht për gjashtë (6) pozitat e punës *Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë*-Divizioni për Inspektim në Rajonin e Ferizajt, kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër procedurës së njëjtë të rekrutimit, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.1372/2025, të datës 27.10.2025, ka anuluar në tërësi këtë procedurë rekrutimi.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1555/2025, të datës 07.08.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1372/2025, të datës 27.10.2025, rrjedhimisht ka anuluar procedurën e pranimit sipas konkursit me numër reference RN00017332, atëherë mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*. Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.1555/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1555/2025, të datës 07.08.2025.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1555/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit G.H;
- Divizionit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendrorë të Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.